




NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE STACIONI I AUTOBUSËVE SH.A. JAVNO LOKALNO PREDUZEĆE AUTOBUSKA STANICA D.D. PUBLIC ENTERPRISE LOCAL BUS STATION J.S.C.	
Nr. 02/13	Data 05.01 2015
No.	Date
PRISHTINË/A	



Në pajtim me dispozitat e Kodit të etikës dhe Qeverisjes së korporatave për NPQ, ZM nr. 509/2009, të dt. 30.4.2009, Komisioni komunal i aksionareve i ndërmarrjes publike lokale "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë, më 29.12.2014, miratoi

## KODIN E ETIKËS DHE QEVERISJES KORPORATIVE PËR NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A., PRISHTINË

### SEKSIONI I

#### OBJEKTIVAT DHE PRAKTIKAT

##### 1. Të përgjithshme.

(a) Kodi për qeverisjen e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë (në tekstin e mëtejme "Kodi"), ka për qëllim promovimin e praktikave efikase dhe të përgjithshme për qeverisjen e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë. Në këtë kuptim, Kodi duhet të paraqesë kriteret që do të zbatohen nga organet e ndërmarrjes për ushtrimin e lirisë së veprimit, e cila u lejohe atyre në bazë të Statutit dhe Ligjit në fuqi.

(b) Kodi duhet të lexohet në lidhje me kornizën rregullative të ndërmarrjes, e zbatueshme në Republikën e Kosovës, për të përfshirë Ligjin nr. 2008/03 - L - 087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 31/2008), Ligjin nr. 04/L - 111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 087, për ndërmarrjet publike ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 13/2012), Ligjin nr. 2007/02 - L - 123, për shoqërinë tregtare dhe Statutin e ndërmarrjes, ashtu siç plotësohet kohë pas kohe. Nëse ndonjëra prej dispozitave në këtë kod bie ndesh me dispozitat e dokumenteve të lartpërmendura, atëherë zbatim gjejnë dispozitat e ligjeve të cekura më lart.

(c) Fjalët dhe shprehjet në Statutin e ndërmarrjes do ta kenë të njëjtin kuptim dhe efekt edhe në këtë kod, vetëm në rast se shprehet ndryshe ose nëse konteksti e kërkon ndryshe.

## 2. Natyra obliguese dhe interpretimi.

Kodi do të jetë i detyrueshëm për ndërmarrjen, Bordin e drejtorëve, Komisionin e auditit dhe zyrtarët e NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A., Prishtinë.

## SEKSIONI II

### RAPORTI NË MES TË ZYRTARËVE DHE BORDIT

#### 3. Përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv (KE)

(a) KE i ndërmarrjes përzgjidhet vetëm në bazë të meritës, veçanërisht Bordi i drejtorëve, duhet të përzgjedhë kandidatin që posedon aftësi për t'i kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tij/saj, i cili është i gatshëm dhe ka mundësi të zbatojë strategjinë e përcaktuar nga Bordi i drejtorëve, dhe i cili ka aftësi të shprehë mendimin e tij objektiv dhe të pavarur në lidhje me interesin e veçantë të ndërmarrjes. Në këtë pikë, KE i ndërmarrjes duhet të përzgjidhet përmes një procesi të hapur, konkurrues dhe transparent, i organizuar si vijon:

(i) Bordi i drejtorëve përcakton kualifikimet minimale dhe të kërkuara për pozitën; kualifikimet e tilla duhet të jenë specifike dhe të lidhura me nevojat e ndërmarrjes dhe sektorin në të cilin ajo operon;

(ii) Shpallja e arsyeshme informative për vend të lirë pune, duhet të publikohet dy herë, së paku në dy gazeta me të lexuara në Kosovë, dhe duhet të shpërndahet nëpërmjet mediave të tjera në Kosovë dhe më gjerë;

(iii) Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve, nuk mund të jetë më i shkurtër sesa një muaj nga data e publikimit të shpalljes për vend të lirë pune;

(iv) Bordi i drejtorëve duhet të udhëzojë një këshilltar të pavarur, kompetent dhe me reputacion, që të vlerësojë të gjithë kandidatët kundrejt kërkesave minimale dhe të krijojë një listë të ngushtë, sipas kualifikimeve të tyre profesionale;

(v) Bordi i drejtorëve duhet të vlerësojë dhe intervistojë një numër të mjaftueshëm kandidatësh (zakonisht, jo më shumë se 4);

(vi) Procesi i përzgjedhjes duhet të përsëritet derisa Bordi i drejtorëve të identifikojë një kandidat të kënaqshëm.

(b) Kandidati i zgjedhur duhet të ketë besueshmërinë e plotë të Bordit të drejtorëve.

(c) Zyrtari Kryesorë per Financa dhe Thesarë (ZKFTH), këshilltari i përgjithshëm /sekretari korporativ, do të përzgjidhen nga KE-ja vetëm në bazë të meritës. Në këtë kuptim, kandidatët propozohen nga KE-ja, për t'u emëruar më pas nga Bordi i drejtorëve. Përzgjedhja bëhet përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues, i krijuar lirshëm nga KE-ja në bazë të analizës së kostove - përfitimeve, në pajtim me politikat e ndërmarrjes për rekrutim dhe me Ligjin në zbatim.

#### **4. Kompetencat e Bordit të drejtorëve, KE-së dhe ZKFTH-së.**

(a) Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se KE-ja gëzon fuqinë e mjaftueshme për menaxhimin konferent të afarizmit dhe detyrave të ndërmarrjes, duke pasqyruar përgjegjësinë e madhe të KE-së për performancën e ndërmarrjes. Në veçanti, Bordi i drejtorëve nuk duhet të ndërhyjë, ose të sfidojë vendimet e KE-së, sa i përket rekrutimit ose përjashtimit të punëtorëve të ndërmarrjes, ose niveleve të tyre të pagave (tjetër nga ajo e zyrtarëve të ndërmarrjes). Përveç kësaj, anëtarët e Bordit nuk duhet t'u japin udhëzime punëtorëve të ndërmarrjes për çështjet që i përkasin ndërmarrjes, në rast se ata nuk veprojnë në kapacitetin e tyre si konsumatorë të ndërmarrjes. Me kusht që Bordi, si organ grumbullues, i nënshtrohet dispozitave të këtij Kodi dhe Statutit të ndërmarrjes, mund t'u japë udhëzime zyrtarëve të ndërmarrjes. (Bordi, si organ grumbullues, mund t'u japë udhëzime zyrtarëve të ndërmarrjes, vetëm në përputhje me këtë kod dhe Statutin e ndërmarrjes.)

(b) Bordi i drejtorëve do të kufizojë brenda kompetencave të veta, përmes kërkesës për autorizimin e tij paraprak, vetëm veprimet ose transaksionet më të rëndësishme, të cilat parashtrajnë rreziqe për strukturën industriale ose financiare të ndërmarrjes, duke i identifikuar ato mbi bazat e natyrës dhe masave të tyre: transaksionet e tilla natyrisht se do të përfshijnë përvetësimin dhe shitjen e bizneseve të mëdha ose degëve të tyre, të cilat përfaqësojnë së paku 10% të qarkullimit vjetor të ndërmarrjes, gjetjen e garantuesve për detyrimet e mëdha dhe detyrimet tjera të hapura të palës së tretë.

(c) Në çdo rast, Bordi i drejtorëve do të ruajë kompetencën për të marrë vendime, ose për të autorizuar çështjet që bien brenda menaxhimit ditor të ndërmarrjes.

(d) Bordi i drejtorëve nuk do të shqyrtojë në detaje veprimet ose vendimet, që

bien brenda menaxhimit ditor të ndërmarrjes, me përjashtim të detyrave të saj për mbikëqyrje.

(e) Bordi i drejtorëve mund të kufizojë kompetencat e KE-së, duke kërkuar nënshkrimin e KE-së vetëm në vendimet që kanë të bëjnë me veprimet ose transaksionet, të cilat derisa janë të një madhësie të konsiderueshme ( në kriterin e njëjtë të paraqitur në seksionin II.4 (b) më sipër ), nuk krijojnë rreziqe të mëdha për strukturën financiare dhe industriale të ndërmarrjes.

(f) Bordi i drejtorëve do të sigurojë që KE-ja të gëzojë kompetencën e mjaftueshme për të menaxhuar në mënyre të suksesshme çështjet financiare të ndërmarrjes. Bordi do t'i kufizojë të drejtat e KE-së vetëm në raste të marrjes së këtyre kompetencave për veti (bordi) brenda kufijve të përcaktuar në seksionin II.4 (b) të Kodit, ose në rast të kërkesës për nënshkrim të përbashkët me KE-në.

(g) Bordi i drejtorëve vendos që t'ia japë KE-së udhëzimet për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes, këtij të fundit nuk do t'i kufizohet liria e veprimit për të modeluar raportin e drejtpërdrejtë që sjell KE-ja. Në çdo rast, Bordi i drejtorëve mund të vendosë të mos ia japë KE-së udhëzimet e detajuara për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes.

## **5. Detyrat e mbikëqyrjes së Bordit të drejtorëve.**

(a) Bordi i drejtorëve do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze, veçanërisht mbi sjelljen e zyrtarëve të ndërmarrjes (duke përjashtuar zyrtarin e brendshëm për auditim, i cili është në kompetencë ekskluzive të Komisionit të auditimit).

(b) Nëse performanca e ndërmarrjes i shmanget synimeve të vendosura në planin e biznesit të vitit të caktuar, atëherë Bordi i drejtorëve do të kërkojë një raport nga KE-ja, ku do të tregohen arsyet dhe sqarimet për mosfunksionim të duhur dhe të merren masat e duhura përmirësuese.

(c) Në rast se ndërmarrja nuk i përmbush synimet e saj realizuese për dy vite financiare radhazi, Bordi i drejtorëve do ta heqë dhe zëvendësojë KE-në, madje edhe në rast të mungesës së dëshmive të qarta të neglizhencës, me përjashtim të rastit kur del se mosrealizimi ka qenë rezultat i rrethanave ose ngjarjeve të paparashikuara në mënyrë objektive.

## **6. Fuqizimi i detyrave të dhëna në mirëbesim të zyrtarëve.**

(a) Kurdo që informacionet e besueshme dëshmojnë se ndonjë prej zyrtarëve (duke përjashtuar zyrtarin e brendshëm për auditim, i cili është në kompetencë

ekskluzive të Komisionit të auditit) ka vepruar në kundërshtim me detyrat e tij të besueshme, Bordi i drejtorëve do të hulumtojë çështjen pa vonesë.

(b) Nëse Bordi i drejtorëve vërteton se është shkelur një prej detyrave të besueshme të zyrtarit, atëherë ai duhet ta largojë dhe zëvendësojë menjëherë këtë të fundit, dhe të kërkojë dëmshpërblim kundër tij/saj.

### **SEKSIONI III**

#### **TAKIMET E BORDIT DHE KOMISIONIT TË AUDITIT**

##### **7. Takimet e Bordit të drejtorëve**

(a) Bordi i drejtorëve do të përpilojë një orar decidiv të takimeve të rregullta, të cilat parashihen të jenë jo më pak se 6, dhe jo më shumë se 12 takime të rregullta në vit, të cilat do të mbahen në intervale të rregullta mujore. Bordi i drejtorëve duhet të paraqesë rezultate me shkrim, vetëm atëherë kur kjo justifikohet në mënyrë objektive, se mbajtja e një takimi urgjent është i pazbatueshëm.

(b) Në secilin takim të rregullt, Bordi i drejtorëve do të shqyrtojë dhe diskutojë së paku gjendjen financiare dhe performancën afariste të ndërmarrjes, zbatimin e planit të biznesit, planin e investimeve dhe raportet e ZLE - së për transaksionet, vendimet dhe ngjarjet e periudhës përkatëse.

(c) Kryesuesi i Bordit të drejtorëve, do t'i shqyrtojë me kujdes dokumentet e dorëzuara për Bordin e drejtorëve para takimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkojë sqarime ose informacione të tjera nga KE-ja.

(d) Takimet e jashtëzakonshme do të mbahen vetëm atëherë kur thirren. Atëherë kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë zgjidhje nga Bordi i drejtorëve, dhe çështja nuk mund të presë deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme duhet të thirret mbi çështjet që shtrohen në takim.

##### **8. Komisioni i auditit.**

(a) Zyrtari i brendshëm për auditim, do të përzgjidhet në bazë të meritës. Komisioni i auditimit në mënyrë specifike, duhet të përzgjedhë kandidatët që kanë aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi

të tyre. Përzgjedhja do të bëhet nëpërmjet një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe në pajtim me politikat për punësim të ndërmarrjes dhe Ligjin në zbatim.

(b) Mbikëqyrja e zyrtarit të brendshëm për auditim do të bëhet në pajtim me “mutatis mutandis”, rregullat e njëjta të vendosura në seksioni II. 5 të këtij kodi.

(c) Pagat e propozuara për KE, ZKFTH, këshilltarin e përgjithshëm/sekretarin korporativ, zyrtarin e brendshëm për auditim, do të vendosen nga Komisioni i auditimit, në konsultim me Bordin e drejtorëve, në lidhje me pagën e KE-së dhe sekretarit të ndërmarrjes/Sekretarit të përgjithshëm, brenda nivelit të pagave në treg dhe, në ndonjë rast, në nivelin që nuk dëmtohet mundësia e ndërmarrjes për të joshur kandidatët që kanë aftësitë dhe kompetencat e duhura.

(d) Komisioni i auditimit do të takohet para secilit takim të Bordit të drejtorëve, së paku tri ditë më herët, dhe do të caktojë takimet në përputhje me rrethanat. Përveç kësaj, Komisioni i auditimit do të caktojë çdo takim shtesë, i cili mund të kërkohet për përmbushjen e detyrave të tij.

(e) Në secilin takim që do të mbahet para takimeve të Bordit të drejtorëve, Komisioni i auditimit do të shqyrtojë, përveç dokumenteve të përgatitura nga KE-ja për Bordin e drejtorëve, raportet nga zyrtari i brendshëm për auditim lidhur me çështjet e caktuara brenda kompetencave të tij.

(f) Kryesuesi i Komisionit të auditimit do të shqyrtojë me kujdes dokumentet e dorëzuara Komisionit të auditimit nga zyrtari i brendshëm për auditim, para mbajtjes së takimit, në mënyrë që të jetë në gjendje të kërkojë sqarime ose informacione të tjera nga zyrtari i brendshëm për auditim.

(g) Takimet e jashtëzakonshme do të mbahen vetëm kur thirren, kur çështje të rëndësishme dhe urgjente kërkojnë një vendim nga Komisioni i auditimit, dhe çështjet që nuk mund të presin deri në takimin e planifikuar të radhës. Rendi i ditës për takimet e jashtëzakonshme, duhet të thirret mbi çështjen për të cilat është thirrur ai takim.

(h) Për ta lehtësuar ushtrimin e mandatit të tij, Komisioni i auditimit mund të kërkojë edhe një konsultant të jashtëm, si këshilltar. Këshilltari i jashtëm duhet të ketë përvojë të duhur në praktikat e financave dhe kontabilitetit, bashkë me njohurinë mbi praktikat më të mira për auditim.

(i) Komisioni i auditimit do të adoptojë rregullat procedurale për trajtimin konfidencial të informacioneve të mbledhura, si rezultat i programit për denoncim, për shkak të hulumtimeve dhe trajtimit të akuzimeve të pavërteta.

## SEKSIONI IV

### DISPOZITA TË NDRYSHME

#### **9. Vetëvlerësimi i performancës së Bordi të drejtorëve dhe Komisionit të auditimit.**

Bordi i drejtorëve dhe Komisioni i auditimit, do të shqyrtojnë performancat e tyre për çdo vit, në pajtim me kriteret për vlerësim, të krijuara në fillim të vitit financiar, dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit në zbatim.

#### **10. Deklarimi.**

Bordi i drejtorëve do të adaptojë, bashkë me pasqyrat financiare vjetore, një përmbledhje të shkurtër dhe një raport të thjeshtë gjuhësor, duke përmbledhur në mënyre të qartë, të drejtë dhe koherente pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes dhe raportin vjetor, duke u përqendruar në të dhënat kryesore, ngjarjet dhe vendimet e vitit përkatës financiar. Një raport i tillë do të përgatitet nga KE-ja dhe do t'i dorëzohet Komisionit të auditimit dhe Bordit të drejtorëve për miratim, dhe do të publikohet në ueb-faqen e ndërmarrjes, bashkë me pasqyrat vjetore financiare.

#### **11. Kodi i etikës, politikat për staf dhe udhëzuesi i punonjësve.**

(a) KE-ja do të paraqesë para Bordit të drejtorëve, një udhëzues për punonjësit, i cili duhet të përfshijë kodin e etikës dhe politikat për staf, ashtu që, në mënyrë kolektive, të sigurohet se ndërmarrja po i zbaton praktikën e qeverisjes së përgjegjshme dhe efikase në të gjitha fushat përkatëse.

(b) Bord i drejtorëve kërkohet të respektojë dispozitat e zbatueshme të udhëzuesit të punonjësve të ndërmarrjes, kusht që politikat vijuese të ndërmarrjes të jenë të detyrueshme dhe të obligueshme për secilin anëtar të Bordit:

(i) Logot dhe mbishkrimet e ndërmarrjes nuk duhet të përdoren për letra personale ose për ndonjë qëllim jozyrtar të ndërmarrjes;

(ii) Armët, duke përfshirë thikat, armët e zjarrit ose eksplozivet, nuk janë të lejuara brenda objekteve të ndërmarrjes;

(iii) Bordi i drejtorëve nuk duhet të pranojë të holla ose dhurata materiale ose trajtime apo favorizime të tjera të veçanta, të cilat mund të krijojnë, ose duket se

krijonjë një pozitë favorizuese për dikë që bën biznes me ndërmarrjen, duke përfshirë çdo individ, subjekt afarist ose agjenci e cila është në pozitë për të ofruar mallra ose shërbime për ndërmarrjen. Me qëllim të këtij seksioni, "dhuratë", përcaktohet çdo gjë që ka vlerë, duke përfshirë edhe drekat dhe darkat, biletat e fluturimit ose akomodimet në hotel, ose format e tjera të argëtimit. Kjo listë nuk ka për qëllim që të jetë ekskluzive;

(iv) Besueshmëria: Gjatë mandatit të një anëtari të Bordit, ai/ajo do të jetë kofidenciale ndaj informacioneve të ndërmarrjes, që kanë të bëjnë me: dizajnet e produkteve, të dhënat për personelin e ndërmarrjes, parashikimet e ngarkesave, planet për kapacitet, dosjet e tarifave, strategjitë për marketing, informacionet për konsumatorë, politikat për caktimin e çmimit dhe informacionet e tjera lidhur me këto. Këto informacione janë pronësore dhe kritike për suksesin e ndërmarrjes, andaj duhet të mos dalin ose të mos përdoren jashtë objekteve të ndërmarrjes, të mos diskutohen me ndonjë punonjës jashtë ndërmarrjes, vetëm në raste se kjo lejohet nga KE-ja, ose kur kërkohet me Ligjin në zbatim. Ky obligim do të vazhdojë edhe pasi të ketë përfunduar ose përjashtuar mandati i anëtarit të Bordit;

(v) Marrëdhëniet me publikun: Meqë ndërmarrja duhet të flasë në një mënyrë të koordinuar dhe konsistente, vetëm punonjësit e ndërmarrjes, të cilët janë të autorizuar me shkrim nga KE-ja, mund të flasin para mediave lidhur me çështjen që i takon ndërmarrjes. Të gjitha komunikimet me shkrim me media, do të përgatiten nga zyrtari për marrëdhënie me publikun, dhe do të aprovohen nga KE-ja, para se këto komunikime me shkrim të dorëzohen në media. Sipas kësaj, dhe në pajtim me këtë politikë, anëtarët e Bordit duhet të mos flasin e të mos dorëzojnë komunikata me shkrim për media lidhur me gjërat që i përkasin ndërmarrjes.

(c) Anëtarët e Bordit caktohen me paga dhe përfitime vetëm nga Kompania, ashtu siç parashihet me Ligjin në zbatim. Në këtë pikë, dhe sipas dispozitave të seksionit III.8 (h) të këtij kodi, ndërmarrja nuk do t'ju sigurojë (dhe anëtarët e Bordit nuk duhet të kërkojnë) këshilltarë, vetura, kompjuter, telefon ose pajisje të tjera ose përfitime për Bordin e drejtorëve, e as t'u sigurojnë ndonjë zyrë brenda objekteve të ndërmarrjes (përveç për qëllime të mbajtëse së takimeve të Bordit, ose takimeve të Komisionit të auditit).


Ky kod do të hyjë në fuqi më datën e paraqitur më poshtë dhe do të publikohet në ueb-faqen e ndërmarrjes.



Miratuar më 29.12.2014


**KOMISIONI KOMUNAL I AKSIONARËVE**

1. **Muhedin Nushi**




\_\_\_\_\_

2. **Lirie Avdiu**



\_\_\_\_\_

3. **Feti Mehdiu**



\_\_\_\_\_